



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 1283Rep.



VËRTETIM  
(Njësimi)

Sot, më datë 21.09.2018 para meje Noteres në zyrën time të noterisë, me adresë; Rr: "At Gjergj Fishta", kulla nr. 9, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, u paraqit :

Daniela Ndrejaj, e identifikuar me ID me nr.personal J06123035Q , e cila paraqitet për të njësuar me origjinalin dokumentet ligjore të mëposhtëme:

Dokumente Ligjore, ku unë noteria vërtetoj që dokumentet nuk kanë fshirje, as korrigjime dhe njësia është kopje e njëjtë me dokumentin origjinal të fotokopjuar nga une noterja .

Vërtetimi i dokumentit u hartua në bazë të nenit 56 te Ligjit Nr. 7829, dt. 01.06.1994 "PER NOTERINE" ( i ndryshuar) dhe Udhezimit te Ministrit te Drejtesise, Nr. 6891, dt. 17.08.2005 pika 7 e tij .

Pasi iu lexua personit dhe iu bë e qartë përmbajtja, unë Noterja e vërtetoj nënshkrimin sipas Ligjit.



*[Handwritten signature]*



Në bazë të Nenit 33, paragrafi 3, dhe Nenit 86 të Ligjit Nr. 02/L-123 për "Shoqëritë Tregtare," të ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-006 për "Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare," si dhe Nenin 13 të Statutit të Gazeta Express Sh.P.K., MediaWorks Sh.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me numër të regjistrimit të biznesit 70202640 dhe adresë të regjistruar në Perandori Justinian 69, Prishtinë, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, Berat Buzhala, Drejtor Menaxhues, në cilësinë e vet si themeluese dhe aksionare e vetme e Gazeta Express Sh.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me adresë në Perandori Justinian 69, Prishtinë, tash e tutje referuar si "Shoqëria," më 12.03.2018 me këtë rast, miraton këtë:

## MARRËVESHJE TË SHOQËRISË

të

### GAZETA EXPRESS SH.P.K.

#### 1. Interpretimi

1.1 Shprehjet në vijim do të kenë kuptimin e dhënë si më poshtë:

**Aksion** do të thotë interesi pronësor në Shoqëri i mbajtur dhe në pronësi të një personi fizik dhe/apo personi juridik të cilët janë të përcaktuar/regjistruar si pronar(ë) të aksionit(ve) përkatës(e) në Nenin 8 të Statutit.

**Aksionar** do të thotë personi fizik dhe/apo personi juridik që mban/ka në pronësi një apo më shumë Aksione në Shoqëri dhe i/e cili/a është i/e përcaktuar/regjistruar si i/e tillë në Nenin 8.2 dhe Nenin 8.3 të Statutit.

**Ligji për Shoqëritë Tregtare** do të thotë Ligji Nr. 02/L-123 për "Shoqëritë Tregtare," i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-006 për "Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare," siç është dhe siç mund të ndryshohet kohë pas kohe.

**Ligji në Fuqi** do të thotë ligjet, rregulloret, udhëzimet administrative dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë por duke mos u kufizuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, siç janë dhe siç mund të ndryshohen kohë pas kohe.

**Marrëveshja e Shoqërisë** do të thotë kjo Marrëveshje e Shoqërisë e miratuar në pajtim me Nenin 33, paragrafi 3, Nenin 86 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare si dhe Nenin 13 të Statutit, siç është dhe siç mund të ndryshohet kohë pas kohe.

**Shoqëria** do të thotë Gazeta Express Sh.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ekziston sipas Ligjit në Fuqi, me adresë në Perandori Justinian 69, Prishtinë.





Statuti do të thotë Statuti i miratuar së fundmi më 12.03.2018, siç është dhe siç mund të ndryshohet kohë pas kohe në pajtim me dispozitat e Statutit dhe Ligjit në Fuqi.

- 1.2 Shprehjet tjera të përkufizuara në tekstin e Marrëveshjes së Shoqërisë do ta kenë kuptimin e dhënë aty.
- 1.3 Në rast të mospërputhjes ndërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë dhe ndonjë dispozite tjetër të detyrueshme të Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, dispozitat e Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të mbizotërojnë, respektivisht.
- 2. Certifikatat e Aksioneve dhe Regjistri i Aksionarëve të Shoqërisë**
  - 2.1 Aksionet e Shoqërisë lëshohen/emitohen pa certifikata të Aksioneve.
  - 2.2 Shoqëria krijon dhe mirëmban regjistrin e Aksionarëve në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Regjistri i Aksionarëve duhet të përmbajë informatat e parapara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare si dhe çdo informatë tjetër që Aksionarët e konsiderojnë të nevojshme dhe të përshtatshme. Procedura e përfshirjes së informatave të lartpërmendura në regjistrin e Aksionarëve do të zhvillohet në pajtim me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
  - 2.3 Shoqëria lejon Aksionarët të shikojnë dhe të kenë qasje në regjistrin e Aksionarëve dhe, sipas kërkesës së tyre, mund të iu siguroj një ekstrakt të regjistrit të Aksionarëve.
- 3. Rritja e Kapitalit Aksionar/Themeltar të Shoqërisë**
  - 3.1 Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, të Statutit dhe kësaj Marrëveshje të Shoqërisë, Aksionari mund ta rrisë kapitalin aksionar/themeltar të Shoqërisë.
  - 3.2 Rritja e kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë mund të bëhet ose me rritjen e vlerës nominale të Aksioneve ose me emetimin/lëshimin e Aksioneve shtesë.
  - 3.3 Shoqëria – pas pagesës së plotë të kapitalit aksionar/themeltar të rritur nga ana e Aksionarëve – mund të rrisë kapitalin e Shoqërisë me votën afirmative të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi njëqind përqind (100%) të Aksioneve në Shoqëri para vendimit për rritje të kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë.
  - 3.4 Njoftimi për Kuvendin e Aksionarëve, ku rendi i ditës përfshin rritjen e kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë, duhet të përmbajë të paktën informacionin e nevojshëm të kërkuar me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.



- 3.5 Aksionarët kanë të drejtën e përparësisë për të blerë aksionet shtesë të emetuara/lëshuara nga Shoqëria në proporcion me Aksionet e tyre ekzistuese para pritjes së kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë.
- 3.6 Nëse Shoqëria emeton Aksione shtesë apo ndryshon vlerën nominale të Aksioneve, duhet menjëherë të ndryshojë Statutin e vet për të reflektuar këto ndryshime dhe ndryshimet përkatëse të regjistroj sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 4. Zvogëlimi i Kapitalit Aksionar/Themeltar të Shoqërisë**
- 4.1 Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, të Statutit dhe kësaj Marrëveshje të Shoqërisë, Aksionarët mund të zvogëlojnë kapitalin aksionar/themeltar të Shoqërisë.
- 4.2 Zvogëlimi i kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë mund të bëhet me uljen e vlerës nominale të Aksioneve.
- 4.3 Shoqëria mund të zvogëloj kapitalin e Shoqërisë me votën afirmative të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi njëqind përqind (100%) të Aksioneve në Shoqëri para vendimit për zvogëlim të kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë.
- 5. Mbledhja e Kuvendit të Aksionarëve**
- 5.1 Të gjithë personat fizik ose juridik që janë të regjistruar si Aksionarë në regjistrin e Aksionarëve të Shoqërisë në ditën e mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve lejohen të marrin pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë dhe të votojnë për çështjet e Shoqërisë në pajtim me këtë Marrëveshje të Aksionarëve, Statutin dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 5.2 Të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë, përveç takimit të rregullt vjetor, konsiderohen si mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë.
- 5.3 Kuvendi i Aksionarëve merr vendime në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshje të Shoqërisë dhe Statutit.
- 6. Thirrja e Mbledhjessë Kuvendit të Aksionarëve**
- 6.1 Shoqëria mbanë mbledhjene rregullt vjetore të Kuvendit të Aksionarëve jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas mbylljes së vitit kalendarik.
- 6.2 Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Aksionarëve mund të mbahen me kërkesë të Drejtorit Menaxhues të Shoqërisë apo Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi jo më pak se njëzet e pesë përqind (25%) të Aksioneve të Shoqërisë.



6.3 Mbledhja e rregullt apo e jashtëzakonshme e Kuvendit të Aksionarëve mund të shqyrtoj dhe miratojë vetëm vendime për çështjet të cilat janë përfshirë në rendin e ditës për mbledhjen përkatëse, përveç nëse në mbledhjen përkatëse janë të pranishëm dhe marrin pjesë me të drejta të plota votimi të gjithë Aksionarët e Shoqërisë.

6.4 Drejtori Menaxhues e ka të drejtën që të propozoj marrjen e një vendimi nga Kuvendi i Aksionarëve edhe pa mbajtjen formale të mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve. Në këtë rast vendimi konsiderohet i miratuar kur të nënshkruhet nga Aksionarët që mbajnë/kanë në pronësi shumicën e kërkuar të Aksioneve sipas Statutit dhe kësaj Marrëveshje të Aksionarëve.

## 7. Njoftim për Mbledhjen e Kuvendit të Aksionarëve

7.1 Të paktën dhjetë (10) ditë para mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve, Drejtori Menaxhues i Shoqërisë është i detyruar që Aksionarëve të iu dërgoj njoftimin për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve, tash e tutje referuar si “Njoftimi për Mbajtjen e Mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve.”

7.2 Njoftimi për Mbajtjen e Mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve do t’i dërgohet secilit Aksionar në adresën e lartshënuar apo në emailin e tyre zyrtar të deponuar në Shoqëri. Njoftimi për Mbajtjen e Kuvendit të Aksionarëve po ashtu do të iu dërgohet edhe nënpunësve relevant të Shoqërisë [si dhe auditorëve të Shoqërisë].

7.3 Njoftimi për Mbajtje të Mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve duhet të përmbajë kohën dhe vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës të propozuar. Për çdo mbledhje të rregullt apo të jashtëzakonshme të Kuvendit të Aksionarëve, rendi i ditës përfshin çështjet brenda kompetencave të Kuvendit të Aksionarëve sipas kësaj Marrëveshje të Shoqërisë, Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

7.4 Pavarësisht afateve dhe kërkesave të parapara me këtë Nen 7 të Marrëveshjes së Shoqërisë, Aksionarët me vendim unanim mund të heqin dorë nga periudha e njoftimit paraprak për mbajtje të mbledhjes së rregullt dhe/apo të jashtëzakonshme të Kuvendit të Aksionarëve dhe dërgimin paraprak të rendit të ditës.


## 8. Kompetencat e Mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve

8.1 Përveç nëse parashihet ndryshe në këtë Marrëveshje të Shoqërisë apo në Statut, Mbledhja e Kuvendit të Aksionarëve – qoftë e rregullt apo e jashtëzakonshme – ka kompetencë ekskluzive që të marrë vendimet vijuese për Shoqërinë:

(a) ndryshimet dhe plotësimet e Statutit;

- RISE  
NTI  
NE
- (b) ndryshimet dhe plotësimet e Marrëveshjes së Shoqërisë;
  - (c) rritja ose zvogëlimi i kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë;
  - (d) autorizimi ose ratifikimi i një transaksioni me konflikt interesi;
  - (e) zvogëlimi ose lirimi nga detyrimi i një Aksionari për kthimin e shpërndarjeve/dividendave ose shumave të tjera të cilat i janë paguar atij/asaj nëkundërshtim me Nenin 94 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
  - (f) pranimi i një Aksionari të ri;
  - (g) vendim për shpërbërjen vullnetare dhe/apo nisjes e procedurës së falimentimit të Shoqërisë;
  - (h) vendim për të bashkuar dhe/apo ndarë Shoqërinë në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
  - (i) shitja, lënia peng, dhënia e hipotekës ose bartjet tjera të mbi njëzet e pesë përqind (25%) të pasurisë – qoftë të luajtshme, qoftë të paluajtshme – së Shoqërisë;
  - (j) shitja, transferimi, cedimi, ngarkimi, lënia peng apo tjetërsimi ndryshe i Aksioneve në pajtim me Nenin 3 të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë;
  - (k) emetimi i Aksioneve shtesë të Shoqërisë;
  - (l) shpërndarjen e fitimeve/dividendës së Shoqërisë;
  - (m) emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit Menaxhues;
  - (n) përcaktimi i kompensimit fiks dhe bonuseve të Drejtorit Menaxhues të Shoqërisë;
  - (o) zgjedhja e Auditorit të Jashtëm të Shoqërisë; dhe
  - (p) vendimet tjera që sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare i takojnë Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë.

8.2 Vendimet e Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë në lidhje me çështjet e përcaktuara në Nenin 8, paragrafi 1, të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë miratohen me votën afirmative të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi njëqind përqind (100%) të Aksioneve të Shoqërisë.





8.3 Vendimet e Kuvendit të Aksionarëve në lidhje me çështjet e përcaktuara në Nenin 8, paragrafin 1, të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë mund të mos lejojnë apo autorizojnë miratimin e një ndryshimi dhe/apo plotësimi të Statutit dhe/apo të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë që rrit detyrimin e një Aksionari për të bërë kontribute ose eliminon apo zvogëlon të drejtat e një Aksionari, përveç nëse çdo Aksionar i prekur në mënyrë specifike dhe me shkrim ka votuar në favor të një ndryshimi dhe/apo plotësimi të tillë.

## 9. Kuorumi për Mbledhjet e Kuvendit të Aksionarëve

9.1 Mbledhja e Kuvendit të Aksionarëve mund të mbahet vetëm nëse në mbledhje janë të pranishëm Aksionarët që mbajnë shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të Aksioneve të Shoqërisë apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar.

9.2 Në rast të mungesës së kuorumit për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve, të thirrur me rregull, mbledhja e radhës e Kuvendit të Aksionarëve do të mbahet brenda periudhës kohore prej dhjetë (10) ditëve nga data fillestare për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve. Kuorumi për mbajtjen e kësaj mbledhje të Kuvendit të Aksionarëve në këtë rast do të jetë prania e Aksionarëve që mbajnë pesëdhjetë përqind (50%) të Aksioneve të Shoqërisë.

## 10. Kryesimi i Mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve

10.1 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë, ose në mungesë të tij ndonjë zyrtar i Shoqërisë i caktuar nga Drejtori Menaxhues i Shoqërisë, vepron si kryesues në mbledhjet e Kuvendit të Aksionarëve.

10.2 Megjithatë, nëse Drejtori Menaxhues i Shoqërisë, ose në mungesë të tij ndonjë zyrtar i Shoqërisë i caktuar nga Drejtori Menaxhues i Shoqërisë, nuk është i pranishëm brenda tridhjetë (30) minutave pas kohës së planifikuar për fillimin e mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve, Aksionarët e pranishëm që përbëjnë kuorumin zgjedhin një prej Aksionarëve apo zyrtarëve të Shoqërisë të kryesoj mbledhjen e Kuvendit të Aksionarëve.

## 11. Votat e Aksionarëve

11.1 Në mbledhjen e Kuvendit të Aksionarëve, Aksionarët kanë një votë për çdo çështje të ngritur për vendosje, të cilën votë mund ta ushtrojnë ose personalisht ose nëpërmjet të përfaqësuesit të autorizuar, i cili duhet të pajisjet me një autorizim të noterizuar, siç është përcaktuar më poshtë.

11.2 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me kualifikimin e çdo Aksionari me të drejtë vote përcaktohet në mbledhjen e Kuvendit të Aksionarëve. Çdo mosmarrëveshje e tillë i referohet kryesuesit të mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve, vendimi i të cilit është përfundimtar dhe i





zbatueshëm.

- 11.3 Emërimi i përfaqësuesve të autorizuar të Aksionarëve duhet të jetë me shkrim dhe i noterizuar. Një kopje origjinale ose e vërtetuar e autorizimit të noterizuar i dërgohet kryesuesit të mbledhjes së Aksionarëve jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë para fillimit të mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve.
- 11.4 Votimi në mbledhje të Kuvendit të Aksionarëve bëhet me ngritje të dorës të Aksionarëve apo përfaqësuesve të tyre, përveç nëse Aksionarët në mënyrë unanime janë pajtuar që votimi të jetë i fshehtë.

## 12. Drejtori Menaxhues i Shoqërisë

- 12.1 Shoqëria do të ketë një Drejtor Menaxhues.
- 12.2 Drejtori Menaxhues është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë.
- 12.3 Drejtori Menaxhues emërohet dhe shkarkohet me votën afirmative Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi njëqind përqind (100%) të aksioneve të Shoqërisë.
- 12.4 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë është Berat Buzhala, me numër personal të identifikimit 1013396767, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, dhe me vendbanim në Veternik, Mbrapa Grand Store, Prishtinë, Kosovë.

## 13. Kompetencat e Drejtorit Menaxhues të Shoqërisë


- 13.1 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë do të përfaqësojë dhe detyroj ligjërisht Shoqërinë në raportet e Shoqërisë me palët e treta dhe autoritetet publike dhe do të udhëheqë/qeverisë/menaxhojë të gjitha veprimet afariste/biznesore të Shoqërisë, përveç nëse parashihet ndryshe në Statut dhe/apo me Marrëveshjen e Shoqërisë.
- 13.2 Pa kufizuar kompetencat e Drejtorit Menaxhues të Shoqërisë të parapara me Nenin 13, paragrafin 1, të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë, Drejtori Menaxhues ka kompetencë ekskulzive për çështjet në vijim:
- (a) hartimin dhe zbatimin e planit të punës dhe afarist/biznesor të Shoqërisë;
  - (b) punësimin, caktimin e pagave dhe bonuseve si dhe shkarkimin e të gjithë punëtorëve të Shoqërisë;
  - (c) lidhjen e kontratave dhe/apo marrëveshjeve komerciale për dhe në emër të Shoqërisë; dhe



- (d) të siguroj që Shoqëriazbaton dhe respekton Ligjin në Fuqi.
- 13.3 Drejtori Menaxhues mund të emëroj një apo më shumë Ndhimës Drejtor për çështje të caktuara që do ta këshillojnë dhe/apo ndihmojnë për përmbushjen e detyrave të veta. Ndhimës Drejtorët e emëruar nga Drejtori Menaxhues do të shkarkohen nga Drejtori Menaxhues.
- 13.4 Drejtori Menaxhues dhe Ndhimës Drejtorët e emëruar nga ai janë të detyruar që – gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre – të iu përmbahen detyrimeve në vijim:
- (a) të veprojnë për dhe në interes të Shoqërisë si tërësi;
  - (b) të ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm për qëllimet e parapara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Statut dhe këtë Marrëveshje të Shoqërisë;
  - (c) të shmangin konfliktet aktuale dhe potenciale të interesave personale me interesat e Shoqërisë; dhe
  - (d) të ushtrojnë kompetencat e tyre me kujdes të arsyeshëm.
14. **Emërimi, Caktimi i Kompensimit dhe Bonuseve si dhe Shkarkimi i Drejtorit Menaxhues**
- 14.1 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë emërohet – me mandat të pacaktuar në kohë – me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi njëqind përqind (100%) të Aksioneve në Shoqëri. Emërimi shoqërohet me lidhjen e kontratës së punës për periudhë të pacaktuar kohore ndërmjet Shoqërisë dhe Drejtorit Menaxhues.
- 14.2 Kompensimi dhe Bonuset e Drejtorit Menaxhues caktohen me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi njëqind përqind (100%) të Aksioneve në Shoqëri.
- 14.3 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe/apo Shkelje të Ligjit në Fuqi vetëm me vendimin afirmativ Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi njëqind përqind (100%) të Aksioneve në Shoqëri.
15. **Qasja në të Dhënat e Shoqërisë**
- 15.1 Çdo Aksionar ka të drejtë të kërkoj nga Drejtori Menaxhuesi Shoqërisë qasjenë çdo libër, dokument dhe të dhëna tjetër të Shoqërisë pa kufizime.



- 15.2 Në veçanti, çdo Aksionar ka të drejtë të marrë kopje të çfarëdo të dhënave dhe/apo dokumenteve të Shoqërisë.
- 16. Viti Afarist, Pasqyrat Financiare dhe Shpërndarja e Fitimit/Dividendave të Shoqërisë**
- 16.1 Viti afarist i Shoqërisë është në përputhje me vitin kalendarik.
- 16.2 Drejtori Menaxhues – nëpërmjet të zyrtarëve të brendshëm apo të jashtëm të kontabilitetit dhe auditimit – përgatitë pasqyrat financiare të [audituar] të Shoqërisë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga fundi i vitit afarist/kalendarik.
- 16.3 Përcaktimi i fitimit dhe humbjes për qëllime të pasqyrave financiare bëhet në përputhje me Ligjin në Fuqi.
- 16.4 Pasqyrat financiare të Shoqërisë miratohen në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë.
- 16.5 Secili fitim i realizuar në vitin paraprak shpërndahet/paguhet si fitim/dividend tek Aksionarët, në proporcion me Aksionet që mbajnë/kanë në pronësi, përveç nëse mbledhja e Kuvendit të Aksionarëve vendos ndryshe.
- 16.6 Fitimi/dividenda shpërndahet/paguhet tek Aksionarët e Shoqërisë vetëm nëse nuk ekzistojnë asnjë nga kufizimet e parashikuara në Nenin 93 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 16.7 Vetëm Aksionarët të cilët janë në regjistrin e Aksionarëve dhe janë të përcaktuar dhe regjistruar si të tillë në Statut në ditën e mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve, ku shpallen fitimet/dividendat, kanë të drejtë të marrin këto fitime/dividenda.
- 17. Njoftimet**
- 17.1 Çdo njoftim që lëshohet/ipet për Aksionarë lidhje me këtë Marrëveshje të Shoqërisë bëhet me shkrim dhe në adresat e Aksionarëve të dhëna këtu dhe/apo email më email adresat e dorëzuara nga Aksionarët në Shoqëri.
- 17.2 Komunikimi me email konsiderohet të jetë komunikim me shkrim për qëllime të këtij Neni 17 të Marrëveshjes së Shoqërisë.
- 17.3 Aksionari që është i pranishëm në një mbledhje të Shoqërisë, qoftë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar, konsiderohet se ka marrë njoftimin për mbledhjen për të cilat mbledhja është organizuar.



**18. Ligji Qeverisës dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- 18.1 Kjo Marrëveshje e Shoqërisë qeveriset nga dhe interpretohet në pajtim me Ligjin në Fuqi.
- 18.2 Aksionarët do të përpiqen të zgjidhin secilën dhe të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet vete në mënyrë miqësore.
- 18.3 Në rast se zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mënyrë miqësore nuk mund të bëhet brenda afatit kohor prej njëzet (20) ditëve, secili Aksionar ka të drejtë që zgjidhjen e mosmarrëveshjes ta kërkoj pranë gjykatës kompetente.

**19. Shpërbërja Vullnetare dhe Falimentimi i Shoqërisë**

- 19.1 Shpërbërja vullnetare e Shoqërisë miratohet me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi njëqind përqind (100%) të Aksioneve të Shoqërisë.
- 19.2 Shpërbërja vullnetare e Shoqërisë do të bëhet në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 19.3 Nisja e procedurës për falimentim të Shoqërisë miratohet me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi njëqind përqind (100%) të Aksioneve të Shoqërisë.
- 19.4 Procedura e falimentimit të Shoqërisë do të zhvillohet në pajtim me Ligjin në Fuqi.

**20. Ndarja dhe Bashkimi i Shoqërisë**

- 20.1 Ndarja e Shoqërisë miratohet me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi njëqind përqind (100%) të Aksioneve të Shoqërisë.
- 20.2 Bashkimi i Shoqërisë me ndonjë subjekt tjetër juridik miratohet me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi njëqind përqind (100%) të Aksioneve të Shoqërisë.
- 20.3 Ndarja dhe bashkimi i Shoqërisë do të bëhet në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.



**21. Dispozitat Përfundimtare**

- 21.1 Kjo Marrëveshje e Shoqërisë hyn në fuqi më 12.03.2018.
- 21.2 Kjo Marrëveshje e Shoqërisë mund të ndryshohet dhe/apo plotësohet me votën afirmative të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi njëqind përqind, (100%) të aksioneve të Shoqërisë.

- 21.3 Në rast të miratimit të ndryshimit të kësaj Marrëveshje e Shoqërisë, aksionarët do të përgatisin dhe miratojnë tekstin e ndryshuar dhe të rishkruar (konsoliduar) të Marrëveshjes së Shoqërisë.

Aksionar i vetëm i Gazeta Express Sh.P.K., MediaWorks Sh.P.K.

përfaqësuar nga  
**BERAT BUZHALA**

MediaWorks Sh.P.K.  
LLC - 1502



1 1 2



REPUBLIKA E KOSOVËS  
NOTERE MERITA KOSTANICA

Numri Rendor i LRP 1141/2018

-----VËRTETIM NËNSHKRIMI-----

Sot, me 12.03.2018 (dymbëdhjetë mars dy mijë e tetëmbëdhjetë), para meje, Merita Kostanica, Notere me seli në Rr. "Zahir Pajaziti", Hyrja, Nr. 20, Kati 1, Numër 1, Prishtinë, u paraqit:-----

BERAT BUZHALA, i lindur në Çabiq me datë 22.11.1975, emri i babës Bashor, sipas deklaratës së tij me adresë në Veternik, Mbrapa Grand Store, Prishtinë 10000, Kosovë, identiteti i të cilit është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 1013396767, i lëshuar nga MPB me datë skadimi 28.08.2027, i cili paraqitet në cilësinë e njërit prej Aksionarëve si dhe Drejtorit të N.B. "Media Works" Sh.p.k., e regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me seli në Prishtinë, Perandori Justinian, 69, me numër të regjistrimit të biznesit 70202640, fakt i cili konstatohet edhe nga Informata mbi Biznesin të datës 12.03.2018, dhe "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË N.B. "Media Works" Sh.p.k." të datës 01.03.2018, të sjella nga vetë pala te Noterja, i cili kërkon nga ana e Noteres:-----

Vërtetimin e nënshkrimit të tij në dokumentin e sjellur, të përgatitur nga vet ai, përkatësisht në dokumentin "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË GAZETA EXPRESS SH.P.K.", i datës 12.03.2018, i cili ka gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) faqe dhe 6 (gjashtë) fletë dhe i është bashkangjitur këtij vërtetimi. Ky dokument është sjellur nga pala në 3 (tri) kopje. -----


Këtu e tutje, në përputhje me Nenin 45 të Ligjit të Noterisë, Noterja vërteton se: -----

1. BERAT BUZHALA me të dhënat e lartëshënuara dhe në cilësinë e lartëshënuar në emër të N.B. "Media Works" Sh.p.k., në prani të Noteres, ka vënë nënshkrimin e tij në çdo faqe të dokumentit "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË GAZETA EXPRESS SH.P.K.", i datës 12.03.2018, në gjithësej 3 (tri) kopje. -----

Nënshkrimet janë vënë në dokumentin përkatës në praninë e Noteres në selinë e N.B. "Media Works" Sh.p.k., me adresë në: Prishtinë, Perandori Justinian, numër 69 dhe atë me kërkesë të palës.-----

Gjithësej janë vënë 33 (tridhjetë e tri) nënshkrime para Noterit në gjithësej 3 (tri) kopje të dokumentit të lartëshënuar.-----

Noterja nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e Dokumentit "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË GAZETA EXPRESS SH.P.K.", i datës 12.03.2018. -----



Ky vërtetim ka gjithësej 2 (dy) faqe dhe 1 (një) fletë. -----

Ky vërtetim është kërkuar nga pala dhe përgaditur nga ana e Noteres në 3 (tri) kopje.-----

Shpenzimet noteriale për vërtetimin e nënshkrimit janë llogaritur në vlerë prej € 33 (tridhjetë e tri euro) + TVSH, në bazë të nenit 29, si dhe vlera prej € 15 (pesëmbëdhjetë euro) +TVSH në bazë të nenit 40, pika 2, në total shuma në vlerë prej 48 (dyzet e tetë) +TVSH, të Udhëzimit Administrativ 02/2012 për Tarifat e Përkohshme Noteriale, bazë për pagesën e shërbimit të noterëve. -----

Identiteti i palës është konstatuar sipas dokumentit të identifikimit me të dhënat e lartëshënuara. Është konstatuar se pala ka aftësi të plotë veprimi. -----

Veprimi i noterizimit u krye në Prishtinë, në selinë e Noteres Merita Kostanica në adresën e lartëshënuar me datën 12.03.2018 (dymbëdhjetë mars dy mijë e tetëmbëdhjetë).-----





Vërtetim kopje nga dokumenti original. -----

Në përputhje me Nenin 43 të Ligjit për Noterinë, vërtetohet se ky dokument është kopje e dokumentit original "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË GAZETA EXPRESS SH.P.K., i datës 12.03.2018, nënshkrimet e të cilit janë vërtetuar te Noteri, në bazë të „VËRTETIM NËNŠHKRIMI“ me numër rendor LRP. 1141/2018, më datë 12.03.2018, e cila është identike me originalin e saj, e përcaktuar nga vetë pala si dokument original. -----


Dokumenti përbëhet prej 13(trembëdhjetë)faqe dhe 7(shtatë)fletë dhe e njejta vërtetohet në 2(dy)kopje, në vlerë prej € 26(njëzet e gjashtë euro). -----

Ky vërtetim është kërkuar "GAZETA EXPRESS" SH.P.K. me numër të regjistrimit të biznesit 810104183, përfaqësuar nga VJOLLCA MUSA, e lindur në Mitrovicë me datë 07.03.1963, emri i babës Hashim, sipas deklaratës së saj me adresë në Bregu i Diellit, Zona Perendim Hyrja 4/13, Prishtinë, identiteti i të cilës është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 2003940317, i lëshuar nga MPB, me datë skadimi 22.11.2026. -----


Noterja vërteton se kjo kopje është bërë në zyrën noteriale dhe në të gjitha pikëpamjet është konform (kopje autentike) me dokumentin original që i'u prezantua noteres nga vetë pala. -----

Noterja nuk mbanë përgjegjësi për përmbajtjen e Dokumentit. -----

Prishtinë, Notere Merita Kostanica, me datë 11.09.2018. -----




APOSTILLE (Convention de La Haye du 5 Octobre 1961)	
1. Shteti/Drasava/Country REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO	
Ky dokument publik / Ovaj javni dokument / This public document	
2. është firmosur nga/je potpisan od strane/has been signed by <u>M. KOSTANICA</u>	
3. I cili vepron në cilësinë e/knji deluje u svojstvu/acting in the capacity of <u>NOTERE</u>	
4. dhe mban vulën/pulën/i zadržava pečat/markicu/has the seal/stamp of <u>O.N.K</u>	
Vërtetohet / Potvrđuje se / Certified	
5. në/u/at <u>PRISHTINE</u>	6. datë/datum/date <u>12.09.2018</u>
7. nga/od/by <u>DSK/MPJ</u>	
8. nr/br/no <u>5545718</u>	
9. vula/pulla/pečat/markica/seal/stamp	10. nënshkrimi/potpis/signature:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 1283 Rep.



VËRTETIM  
(Njësimi)

Sot, më datë 21.09.2018 para meje Noteres në zyrën time të noterisë, me adresë; Rr: "At Gjergj Fishta", kulla nr. 9, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, u paraqit :

Daniela Ndrejaj, e identifikuar me ID me nr.personal J06123035Q , e cila paraqitet për të njësuar me origjinalin dokumentet ligjore të mëposhtëme:

Dokumente Ligjore, ku unë noteria vërtetoj që dokumentet nuk kanë fshirje, as korrigjime dhe njësia është kopje e njëjtë me dokumentin origjinal të fotokopjuar nga une noterja .

Vërtetimi i dokumentit u hartua në bazë të nenit 56 te Ligjit Nr. 7829, dt. 01.06.1994 "PER NOTERINE" ( i ndryshuar) dhe Udhezimit te Ministrit te Drejtesise, Nr. 6891, dt. 17.08.2005 pika 7 e tij .

Pasi iu lexua personit dhe iu bë e qartë përmbajtja, unë Noterja e vërtetoj nënshkrimin sipas Ligjit.




*[Handwritten signature]*



113



Në bazë të Nenit 33, paragrafi 3, dhe Nenit 86 të Ligjit Nr. 02/L-123 për "Shoqëritë Tregtare," të ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-006 për "Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare," si dhe Nenit 14 të Statutit të N.B. "Media Works" Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me numër të regjistrimit të biznesit 70202640 dhe adresë të regjistruar në Perandori Justinian 69, Prishtine **BERAT BUZHALA**, me numër personal të identifikimit 1013396767, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, dhe vendbanim në Veternik, mrapa Grand Store, Prishtine; **VJOLLA MUSA**, me numër personal të identifikimit 2003940317, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, dhe vendbanim në Bregu i Diellit, Zona Perendim 4/13, Prishtine; **ARTAN LAHAJ**, me numër personal të identifikimit 1001144703, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, dhe vendbanim në Kalabria, Bl.B2, LL.B #26; **LEONARD KËRQUKU**, me numër personal të identifikimit 1001478342 të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, dhe vendbanim në Lagjja 038 pn, Veternik, Prishtine; **SHPEND LIMONI**, me numër personal të identifikimit 1003064421, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës dhe vendbanim në Hodonoc, Kamenice; dhe **ARBEN HYSENI**, me numër personal të identifikimit 1009408106, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, dhe vendbanim në Sali Ceku, Dardania 1, Peje, duke vepruar në cilësinë e tyre si aksionarë të N.B. "Media Works" Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me numër të regjistrimit të biznesit 70202640 dhe adresë të regjistruar në Perandori Justinian 69, Prishtine, më 01.03.2018, me këtë rast, miratojnë këtë:



## MARRËVESHJE TË SHOQËRISË

të

N.B. "Media Works" Sh.p.k.

### 1. Interpretimi

1.1 Shprehjet në vijim do të kenë kuptimin e dhënë si më poshtë:

**Aksion** do të thotë interesi pronësor në Shoqëri i mbajtur dhe në pronësi të një personi fizik dhe/apo personi juridik të cilët janë të përcaktuar/regjistruar si pronar(ë) të aksionit(ve) përkatës(e) në Nenin 8 të Statutit.

**Aksionar** do të thotë personi fizik dhe/apo personi juridik që mban/ka në pronësi një apo më shumë Aksione në Shoqëri dhe i/e cili/a është i/e përcaktuar/regjistruar si i/e tillë në Nenin 8.2 dhe Nenin 8.3 të Statutit.

**Aksionarë Shumicë** do të thotë Aksionarët që mbajnë 75% të Aksioneve në Shoqëri.

**Aksionarë Pakicë** do të thotë Aksionarët që mbajnë 25% të Aksioneve në Shoqëri.

Faqe 1 nga 16





Ligji për Shoqëritë Tregtare do të thotë Ligji Nr. 02/L-123 për "Shoqëritë Tregtare," i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-006 për "Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare," siç është dhe siç mund të ndryshohet kohë pas kohe.

Ligji në Fuqi do të thotë ligjet, rregulloret, udhëzimet administrative dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë por duke mos u kufizuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, siç janë dhe siç mund të ndryshohen kohë pas kohe.

Marrëveshja e Shoqërisë do të thotë kjo Marrëveshje e Shoqërisë e miratuar në pajtim me Nenin 33, paragrafi 3, Nenin 86 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare si dhe Nenin 14 të Statutit, siç është dhe siç mund të ndryshohet kohë pas kohe.

Shoqëria do të thotë N.B. "Media Works" Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ekziston sipas Ligjit në Fuqi, me numër të regjistrimit të biznesit 70202640 dhe adresë të regjistruar në Perandori Justinian 69, Prishtinë.

Statuti do të thotë Statuti i Ndryshuar dhe i Rishkruar (Konsoliduar) i Shoqërisë, i miratuar së fundmi më 01.03.2018, siç është dhe siç mund të ndryshohet kohë pas kohe në pajtim me dispozitat e Statutit dhe Ligjit në Fuqi.

- 1.2 Shprehjet tjera të përkufizuara në tekstin e Marrëveshjes së Shoqërisë do ta kenë kuptimin e dhënë aty.
- 1.3 Në rast të mospërputhjes ndërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë dhe ndonjëdispozite tjetër të detyrueshme të Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, dispozitat e Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të mbizotërojnë, respektivisht.
2. **Certifikatat e Aksioneve dhe Regjistri i Aksionarëve të Shoqërisë**
  - 2.1 Aksionet e Shoqërisë lëshohen/emitohen pa certifikata të Aksioneve.
  - 2.2 Shoqëria krijon dhe mirëmban regjistrin e Aksionarëve në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Regjistri i Aksionarëve duhet të përmbajë informatat e parapara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare si dhe çdo informatë tjetër që Aksionarët e konsiderojnë të nevojshme dhe të përshtatshme. Procedura e përfshirjes së informatave të lartpërmendura në regjistrin e Aksionarëve do të zhvillohet në pajtim me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
  - 2.3 Shoqëria lejon Aksionarët të shikojnë dhe të kenë qasje në regjistrin e Aksionarëve dhe, sipas kërkesës së tyre, mund të iu siguroj një ekstrakt të regjistrit të Aksionarëve.

3. **Transferimi, Lënia Peng e Aksioneve dhe të Drejtat e Përgjithshme të Parablerjes së Aksioneve të Shoqërisë**

3.1 Aksionet janë pronë personale e Aksionarëve, janë të transferueshme, të ndashme dhe mund të ngarkohen nga Aksionarët në pajtim me dispozitat e Statutit dhe Marrëveshjes së Shoqërisë.

3.2 Çdo shitje, transferim i pronësisë, ndarje, ngarkim dhe/apo lënie peng e Aksioneve të Shoqërisë, si dhe çdo transferim i pronësisë, ngarkim dhe/apo lënie peng e pjesëve të Aksioneve, nuk ështëi vlefshëm nëse nuk është kryer sipas dispozitave të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë dhe nuk është miratuar nga Kuvendi i Aksionarëve me votën afirmative të Aksionarëve që mbajnë së paku 75% të Aksioneve të Shoqërisë.

3.3 Pa kufizuar fushëveprimin e gjerë të Nenit 3.2 të Marrëveshjes së Shoqërisë, asnjë Aksionar në mënyrë vullnetare ose jo-vullnetare nuk ka të drejtën të ngarkoj dhe/apo të lë peng Aksionet e veta në Shoqëri, me përjashtim të rasteve kur ngarkimi bëhet me qëllim të sigurimit të një kredie, huaje apo detyrimi të Shoqërisë, dhe kur marrëveshja sipas të cilës ngarkohen Aksionet shprehimisht parashihet si në vijim:

(a) se personi fizik dhe/apo personi juridik në dobi të së cilit/ës janë ngarkuar apo lënë peng Aksionet nuk ka asnjë kompetencë vendimmarrje, votuese apo të menaxhimit në Shoqëri, si pasojë e ngarkesës dhe/apo pengut të vendosur mbi Aksionet përkatëse në dobi të tij/saj/vet, gjatë kohëzgjatjes së ngarkesës dhe/apo pengut; dhe

(b) marrëveshja sipas të cilës janë ngarkuar dhe/apo lënë peng Aksionet përmban pajtimin eksplicit të personit fizik dhe/apo personit juridik në dobi të së cilit/ës janë ngarkuar dhe/apo lënë peng Aksionet se do t'i nënshtrohet dispozitave të Statutit dhe kësaj Marrëveshje të Shoqërisë; dhe

(c) ngarkimi dhe/apo lënia peng e Aksioneve të Aksionarit përkatës, dhe marrëveshja në bazë të së cilës Aksionet përkatëse janë ngarkuar dhe/apo lënë peng Aksionet përkatëse, është miratuar me votën afirmative të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi së paku 75% të Aksioneve në Shoqëri.

3.4 Në rast se një Aksionar, tash e tutje referuar si "Aksionari Ofertues," dëshiron që – në bazë të një oferte të arsyeshme komerciale të dhënë në mirëbesim nga një palë e tretë që nuk është e ndërlidhur me Aksionarin Ofertues – të shes, transferoj pronësinë, cedoj, ngarkoj, apo përndryshe t'i tjetërsoj Aksionet e veta përkatëse që i mban/ka në pronësi aktualisht apo që mund t'i mbaj/ketë në pronësi në të ardhmen në Shoqëri, tash e tutje referuar si "Aksionet e Ofruara," Aksionari Ofertues është i detyruar që Aksionarëve të Shoqërisë (përveç Aksionarit Ofertues) të iu dorëzojë një njoftim me shkrim i cili përmban së paku informatat në vijim: (i) emrin dhe adresën e plotë të përfituesit të mundshëm të Aksioneve të Ofruara,



duke përfshirë edhe informatat sa i përket ndërlidhjeve eventuale të tij/saj me Aksionarin Ofertues; (ii) numrin e Aksioneve të Ofruara; (iii) kopjen e noterizuar të ofertës së detyrueshme nga përfituesi i mundshëm i Aksioneve të Ofruaraku përfshihen së paku kushtet kryesore komerciale të blerjes, transferimit, ngarkimit, lënies peng dhe/apo tjetërsimit të Aksioneve të Ofruara, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në çmimin e blerjes së Aksioneve të Ofruara; dhe (iv) ofertën e detyrueshme për shitje të Aksioneve të Ofruara drejtuar secilit prej Aksionarëve të Shoqërisë (përveç Aksionarit Ofertues), sipas kushteve të pranuar nga përfituesi i mundshëm i Aksioneve të Ofruara, tash e tutje referuar si “Njoftimi i Shitjes.”

- 3.5 Njoftimi i Shitjes duhet të iu sigurojë secilit prej Aksionarëve të Shoqërisë (përveç Aksionarit Ofertues) të drejtën e blerjes së Aksioneve të Ofruarane përpjesëtim me numrin e Aksioneve të mbajtura/që janë në pronësi nga secili Aksionarë i Shoqërisë (përveç Aksionarit Ofertues), tash e tutje referuar si “Aksionari Blerës.” Njoftimi i Shitjes duhet të parasheh një afat prej më së paku tridhjetë (30) ditë kalendarike nga data e pranimit të Njoftimit të Shitjes, gjatë së cilës periudhë Aksionarët e Shoqërisë (përveç Aksionarit Ofertues) duhet të deklarohen nëse janë të interesuar për ushtrimin e të drejtës së tyre të parablerjes së Aksioneve Ofertuese sipas kushteve të ofertës që Aksionari Ofertues ka pranuar nga pala e tretë/përfituesi i mundshëm i Aksioneve të Ofruara. Aksionarët Blerës do të kenë të drejtën të blejnë pjesën e Aksioneve të Ofruara që korrespondon me përqindjen e Aksioneve që mbajnë/kanë në pronësi në Shoqëri. Pas skadimit të afatit tridhjetë (30) ditor për deklarimin për ushtrimin e të drejtës së parablerjes së Aksioneve të Ofruara, Njoftimi me Shkrim duhet të parasheh edhe një afat shtesë prej shtatë (7) ditëve kalendarike që – në rast se një apo disa Aksionar(ë) Blerës përkatës nuk e ushtro(j)n(ë) të drejtën e vet/tyre të parablerjes – Aksionarët Blerës të tjerë të deklarohen për blerjen e pjesës së Aksioneve të Ofruara të cilat kishin të drejtë t’i parablejnë Aksionarët Blerës që nuk e ushtroan të drejtën e tyre parablerjes, gjithnjë sipas përqindjes proporcionale të Aksioneve që mbajnë/kanë në pronësi në Shoqëri pas zbritjes së përqindjes së Aksioneve të Aksionarëve Blerës që nuk e ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes.
- 3.6 Aksionarët Blerës që deklarohen për ushtrimin e të drejtës së tyre të parablerjes brenda afateve të parapara me Nenin 3.5 të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë do të nënshkruajnë marrëveshjet/kontratat dhe dokumentet tjera për blerjen e Aksioneve të Ofruara brenda afatit prej shtatë (7) ditësh pas skadimit të afateve të parapara me Nenin 3.5 të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë.
- 3.7 Në rast se asnjë nga Aksionarët Blerës (përveç Aksionarit Ofertues) nuk deklarohet brenda afatit tridhjetë (30) ditor për ushtrimin e të drejtës së parablerjes së Aksioneve të Ofruara, të parapara me Nenin 3.5 të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë, do të konsiderohet se Aksionarët Blerës kanë refuzuar ofertën për parablerje të Aksioneve të Ofruara, të paraqitur në Njoftim për Shitje, dhe kanë hequr dorë nga e drejta e tyre për parablerje të Aksioneve të Ofruara. Në këtë rast, Aksionari Ofertues do të ketë të drejtën që, brenda afatit vijues prej tridhjetë (30)





ditëve, Aksionet e Ofruara – dhe jo më pak Aksionet e Ofruara – të ia shet palës së tretë/përfituesit të mundshëm të Aksioneve të Ofruara, oferta e së cilit/ës ishte përfshirë në Njoftimin me Shkrim.

- 3.8 Në rast se Aksionari Ofertues dëshiron t'ia falë Aksionet e Ofruara ndonjë pale të tretë të ndërlidhur apo jo, Aksionari Ofertues është i detyruar që Aksionarëve Blerës të iu paraqes një njoftim me shkrim sipas të cilit iu ofron – në bazë të përqindjes proporcionale të Aksioneve që mbajnë/kanë në pronësi – blerjen e Aksioneve të Ofruara sipas një çmimi që do të caktohet sipas metodës së vlersimit e cila do të vendoset nga Aksionarët Shumicë, tash e tutje referuar si “Njoftimi për Shitje të Aksioneve në Rast të Faljes,” nga një auditor i licencuar në Kosovë, që është i pavarur nga Aksionarët, tash e tutje referuar si “Auditori për Caktim të Çmimit të Aksioneve të Ofruara.” Aksionarët Blerës kanë të drejtë të deklarohen nëse dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes së Aksioneve të Ofruara dhjetë (10) ditë pas pranimit të Njoftimit për Shitje të Aksioneve në Rast të Faljes. Në rast se një apo më shumë Aksionar(ë) Blerës deklarohen se dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e vet/tyre të parablerjes mbi Aksionet e Ofruara, Aksionarët Blerës përkatës dhe Aksionari Ofertues do të përzgjedhin Auditorin për Caktim të Çmimit të Aksioneve të Ofruara brenda periudhës kohore prej dhjetë (10) ditëve pas skadimit të afatit për deklarim në lidhje me Njoftimin për Shitje të Aksioneve në Rast të Faljes. Auditori për Caktim të Çmimit të Aksioneve të Ofruara do të përcaktoj çmimin e Aksioneve të Ofruara tridhjetë ditë (30) nga data e angazhimit tij/saj, tash e tutje referuar si “Çmimi i Aksioneve të Ofruara.”
- 3.9 Aksionarët Blerës kanë të drejtën që Aksionet e Ofruara t'i blejnë – në bazë të përqindjes së Aksioneve që mbajnë/kanë në pronësi në Shoqëri – brenda periudhës tridhjetë (30) ditore pas përcaktimit të Çmimit të Aksioneve të Ofruara. Në rast se jo të gjithë Aksionarët Blerës blejnë Aksionet e Ofruara sipas përqindjes së Aksioneve që mbajnë/kanë në pronësi në Shoqëri, Neni 3.5 i Marrëveshjes së Shoqërisë zbatohet përshtatshimisht.
- 3.10 Nëse brenda tridhjetë (30) ditëve pas caktimit të Çmimit të Aksioneve të Ofruara asnjë nga Aksionarët Blerës nuk e ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes së Aksioneve të Ofruara, Aksionari Ofertues e ka të drejtën që – brenda periudhës vijuese prej tridhjetë (30) ditëve – Aksionet e Ofruara të ia falë personit fizik dhe/apo personit juridik të specifikuar në Njoftimin për Shitje të Aksioneve në Rast të Faljes.
- 3.11 Pavarësisht dispozitave të përcaktuara më lartë, Aksionarët e kanë të drejtën që me vendim unanimit me shkrim të heqin dorë nga respektimi i afateve kohore të përcaktuara më lartë në rastet në të cilat asnjë nga Aksionarët Blerës nuk është i interesuar të ushtroj të drejtat e veta për parablerje të Aksioneve të Ofruara.
- 3.12 Të drejtat e parablerjes së Aksionarëve sipas këtij Neni 3 të Marrëveshjes së Shoqërisë zbatohen në mënyrë analoge dhe përshtatshimisht edhe ndaj çdo lloj blerje dhe/apo shitje tjetër të Aksioneve, në mënyrë të veçantë për çdo riorganizim të formësë Shoqërisë,



përfshirë por duke mos u kufizuar nëndarjen, bashkimin, kontributet etj. të Shoqërisë, në të cilën Aksionet ose pjesë të Aksioneve të Shoqërisë i transferohen ekskluzivisht ose së bashku me pasurinë tjetër të Shoqërisë në çfarëdo mënyre, përfshirë por duke mos u kufizuar në bazëtë trashëgimisë universale (ose edhe me trashëgimi "të pjesëshme" universale) ose me trashëgimi singulare, ndonjë personi fizik dhe/apo personi juridik tjetër ekzistues apo që do të krijohet si pasojë e transaksionit përkatës.

3.13 Po ashtu, e drejta e parablerjes së Aksionarëve sipas këtij Neni 3 të Marrëveshjes së Shoqërisë zbatohen në mënyrë analoge dhe përshtatshimisht edhe në rast se transferimi i Aksioneve dhe/apo pjesëve të Aksioneveka ardhur si pasojë e vdekjes/shuarjes së një Aksionari dhe/apo është autorizuar/urdhëruar nga gjykata dhe/apo ndonjë tribunal i arbitrazhit.

#### 4. E Drejta e Shitjes dhe Blerjes së Aksioneve në Rast të Pakënaqësisë së Aksionarëve Pakicë me Vendimet e Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë

4.1 Në rast se një apo disa Aksionar(ë) që së bashku apo vet mbajnë/kanë në pronësi jo më shumë se 25% të Aksioneve të Shoqërisë, tash e tutje referuar si "Aksionarët Pakicë," kanë mosmarrëveshje me një apo disa Aksionarë të tjerë të Shoqërisë që së bashku apo vet mbajnë/kanë në pronësi së paku 50% të Aksioneve të Shoqërisë, tash e tutje referuar si "Aksionarët Shumicë," dhe/apo nuk pajtohen me vendimet e Kuvendit të Aksionarëve, Aksionarët Pakicë mund të iu dërgojnë Aksionarëve Shumicë një njoftim me shkrim me të cilin shprehin dëshirën për dalje të plotë, përkatësisht shitje të të gjitha Aksioneve të tyre në Shoqëri Aksionarëve Shumicë, tash e tutje referuar si "Njoftimi për Dalje nga Shoqëria."

4.2 Në rast se Aksionarët Shumicë janë të interesuar të ushtrojnë të drejtën e parablerjes së Aksioneve të Aksionarëve Pakicë, Aksionarët Shumicë – brenda një periudhe kohore prej tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i Njoftimit për Dalje nga Shoqëria – do të iu paraqesin Aksionarëve Pakicë ofertën – në bazë proporcionale – për blerje të Aksioneve të Aksionarëve Pakicë në Shoqëri për një çmim të caktuar i cili nuk do të jetë më i vogël se vlera e Shoqërisë sipas pasqyrave financiare të audituara të Shoqërisë, tash e tutje referuar si "Oferta për Blerje të Aksioneve të Aksionarëve Pakicë."

4.3 Për tu siguruar se çmimi i paraqitur në Ofertën për Blerje të Aksioneve të Aksionarëve Pakicë është i drejtë dhe real, Aksionarët Shumicë duhen që në Ofertën për Blerje të Aksioneve të Aksionarëve Pakicë, njëkohësisht, të ofrojnë shitjen e të gjitha Aksioneve që mbajnë/kanë në pronësi në Shoqëri Aksionarëve Pakicë po sipas çmimit të paraqitur në Ofertën për Blerje të Aksioneve të Aksionarëve Pakicë. Në këtë rast, Aksionarët Pakicë janë të detyruar që – brenda afatit tridhjetë (30) ditor nga pranimi i Ofertës për Blerje të Aksioneve të Aksionarëve Pakicë – ose t'i shesin Aksionet e tyre që mbajnë/kanë në pronësi në Shoqëri për çmimin e paraqitur në Ofertën për Blerje të Aksioneve të

Aksionarëve Pakicëose që – për çmimin e paraqitur në Ofertën për Blerje të Aksioneve të Aksionarëve Pakicë – të blejnë Aksionet që mbahen/janë nëpronësi nga Aksionarët Shumicë.

5. Detyrimi i Aksionarëve Pakicë për të Shitur Aksionet e tyre në Shoqëri në rast të Shitjes së 75% të Aksioneve të Shoqërisë nga Aksionarët Shumicë

5.1 Në rast se Aksionarët Shumicë, pra Aksionarët që mbajnë 75% të Aksioneve të Shoqërisë, vendosin që të gjitha Aksionet e tyre në Shoqëri, tash e tutje referuar si “Aksionet Shumicë,” të ia shesin një pale të tretë që nuk është e ndërlidhur me Aksionarët Shumicë për një çmim të arsyeshëm, Aksionarët Pakicë, që mbajnë deri në 25% të Aksioneve të Shoqërisë, pranojnë dhe marrin detyrimin që të ia shesin Aksionet e veta, tash e tutje referuar si “Aksionet Pakicë,” palës së tretë që ka blerë dhe/apo që synon të blejë Aksionet Shumicë.

5.2 Po që se Aksionarët Pakicë nuk pajtohen të shesin Aksionet Pakicë me çmimin me të cilin janë shitur dhe/apo që do të shiten Aksionet Shumicë, çmimi me të cilin do të shiten Aksionet Pakicë do të vendoset në mënyrën e përcaktuar në Nenin 3, paragrafi 8, i kësaj Marrëveshje të Shoqërisë.

6. Rritja e Kapitalit Aksionar/Themeltar të Shoqërisë


6.1 Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, të Statutit dhe kësaj Marrëveshje të Shoqërisë, Aksionarët mund të rrisin kapitalin aksionar/themeltar të Shoqërisë.

6.2 Rritja e kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë mund të bëhet ose me rritjen e vlerës nominale të Aksioneve ose me emetimin/lëshimin e Aksioneve shtesë.

6.3 Shoqëria – pas pagesës së plotë të kapitalit aksionar/themeltar të rritur nga ana e Aksionarëve – mund të rrisë kapitalin e Shoqërisë me votën afirmative të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi 75% të Aksioneve në Shoqëri para vendimit për rritje të kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë.

6.4 Njoftimi për Kuvendin e Aksionarëve, ku rendi i ditës përfshin rritjen e kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë, duhet të përmbajë të paktën informacionin e nevojshëm të kërkuar me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

6.5 Aksionarët kanë të drejtën e përparësisë për të blerë aksionet shtesë të emetuara/lëshuara nga Shoqëria në proporcion me Aksionet e tyre ekzistuese para rritjes së kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë.

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. To the right of the signatures, there is a circular stamp with the word "PERISE" visible at the top. The signatures are written in a cursive style, and the stamp is partially obscured by them.



- 6.6 Nëse Shoqëria emeton Aksione shtetëse apo ndryshon vlerën nominale të Aksioneve, duhet menjëherë të ndryshojë Statutin e vet për të reflektuar këto ndryshime dhe ndryshimet përkatëse t'i regjistroj sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 7. Zvogëlimi i Kapitalit Aksionar/Themeltar të Shoqërisë**
- 7.1 Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, të Statutit dhe kësaj Marrëveshje të Shoqërisë, Aksionarët mund të zvogëlojnë kapitalin aksionar/themeltar të Shoqërisë.
- 7.2 Zvogëlimi i kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë mund të bëhet me uljen e vlerës nominale të Aksioneve.
- 7.3 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë me votën afirmative të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi 75% të Aksioneve në Shoqëri para vendimit për zvogëlim të kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë.
- 8. Mbledhja e Kuvendit të Aksionarëve**
- 8.1 Të gjithë personat fizik ose juridik që janë të regjistruar si Aksionarë në regjistrin e Aksionarëve të Shoqërisë në ditën e mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve lejohen të marrin pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë dhe të votojnë për çështjet e Shoqërisë në pajtim me këtë Marrëveshje të Aksionarëve, Statutin dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 8.2 Të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë, përveç takimit të rregullt vjetor, konsiderohen si mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë.
- 8.3 Kuvendi i Aksionarëve merr vendime në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshje të Shoqërisë dhe Statutit.
- 9. Thirrja e Mbledhjessë Kuvendit të Aksionarëve**
- 9.1 Shoqëria mbanë mbledhje rregullt vjetore të Kuvendit të Aksionarëve jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas mbylljes së vitit kalendarik.
- 9.2 Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Aksionarëve mund të mbahen me kërkesë të Drejtorit Menaxhues të Shoqërisë apo Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi jo më pak se njëzet e pesë përqind (25%) të Aksioneve të Shoqërisë.
- 9.3 Mbledhja e rregullt apo e jashtëzakonshme e Kuvendit të Aksionarëve mund të shqyrtoj dhe miratojë vetëm vendime për çështjet të cilat janë përfshirë në rendin e ditës për mbledhjen



përkatëse, përveç nëse në mbledhjen përkatëse janë të pranishëm dhe marrin pjesë me të drejta të plota votimi të gjithë Aksionarët e Shoqërisë.

9.4 Drejtori Menaxhues e ka të drejtën që të propozoj marrjen e një vendimi nga Kuvendi i Aksionarëve edhe pa mbajtjen formale të mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve. Në këtë rast vendimi konsiderohet i miratuar kur të nënshkruhet nga Aksionarët që mbajnë/kanë në pronësi shumicën e kërkuar të Aksioneve sipas Statutit dhe kësaj Marrëveshje të Aksionarëve.

**10. Njoftim për Mbledhjen e Kuvendit të Aksionarëve**

10.1 Të paktën dhjetë (10) ditë para mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve, Drejtori Menaxhues i Shoqërisë është i detyruar që Aksionarëve të iu dërgoj njoftimin për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve, tash e tutje referuar si "Njoftimi për Mbajtjen e Mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve."

10.2 Njoftimi për Mbajtjen e Mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve do t'i dërgohet secilit Aksionar në adresën e lartshënuar apo në emailin e tyre zyrtar të deponuar në Shoqëri. Njoftimi për Mbajtjen e Kuvendit të Aksionarëve po ashtu do të iu dërgohet edhe nëpunësve relevant të Shoqërisë.

10.3 Njoftimi për Mbajtje të Mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve duhet të përmbajë kohën dhe vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës të propozuar. Për çdo mbledhje të rregullt apo të jashtëzakonshme të Kuvendit të Aksionarëve, rendi i ditës përfshin çështjet brenda kompetencave të Kuvendit të Aksionarëve sipas kësaj Marrëveshje të Shoqërisë, Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

10.4 Pavarësisht afateve dhe kërkesave të parapara me këtë Nen 9 të Marrëveshjes së Shoqërisë, Aksionarët me vendim unanimit mund të heqin dorë nga periudha e njoftimit-paraparak për mbajtje të mbledhjes së rregullt dhe/apo të jashtëzakonshme të Kuvendit të Aksionarëve dhe dërgimin paraparak të rendit të ditës.

**11. Kompetencat e Mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve**


11.1 Përveç nëse parashihet ndryshe në këtë Marrëveshje të Shoqërisë apo në Statut, Mbledhja e Kuvendit të Aksionarëve – qoftë e rregullt apo e jashtëzakonshme – ka kompetencë ekskluzive që të marrë vendimet vijuese për Shoqërinë:

- (a) ndryshimet dhe plotësimet e Statutit;
- (b) ndryshimet dhe plotësimet e Marrëveshjes së Shoqërisë;



- (c) rritja ose zvogëlimi i kapitalit aksionar/themeltar të Shoqërisë;
- (d) autorizimi ose ratifikimi i një transaksioni me konflikt interesi;
- (e) zvogëlimi ose lirimi nga detyrimi i një Aksionari për kthimin e shpërndarjeve/dividendave ose shumave të tjera të cilat i janë paguar atij/asaj nëkundërshtim me Nenin 94 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- (f) pranimi i një Aksionari të ri;
- (g) vendim për shpërbërjen vullnetare dhe/apo nisjes e procedurës së falimentimit të Shoqërisë;
- (h) vendim për të bashkuar dhe/apo ndarë Shoqërinë në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- (i) shitja, lënia peng, dhënia e hipotekës ose bartjet tjera të mbi njëzet e pesë përqind (25%) të pasurisë – qoftë të luajtshme, qoftë të paluajtshme – së Shoqërisë;
- (j) shitja, transferimi, cedimi, ngarkimi, lënia peng apo tjetërsimi ndryshe i Aksioneve në pajtim me Nenin 3 të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë;
- (k) emetimi i Aksioneve shtesë të Shoqërisë;
- (l) shpërndarjen e fitimeve/dividendës së Shoqërisë;
- (m) emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit Menaxhues;
- (n) përcaktimi i kompensimit fiks dhe bonuseve të Drejtorit Menaxhues të Shoqërisë;
- (o) zgjedhja e Auditorit të Jashtëm të Shoqërisë;
- (p) miratimi i buxhetit të Shoqërisë; dhe
- (q) vendimet tjera që sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare i takojnë Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë.

11.2 Vendimet e Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë në lidhje me çështjet e përcaktuara në Nenin 11, paragrafi 1, të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë, përveç Nenit 11, paragrafit 1(m), të Marrëveshjes së Shoqërisë paragrafit, miratohen me votën afirmative të Aksionarëve që mbajnë shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të Aksioneve të Shoqërisë.



- 11.3 Vendimi i Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë për emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit Menaxhues të Shoqërisë, i paraparë me Nenin 11, paragrafi 1(m), të Marrëveshjes së Shoqërisë miratohet me votën afirmative të Aksionarëve që mbajnë së paku gjashtëdhjetë e pesë (65%) të Aksioneve të Shoqërisë.
- 11.4 Vendimet e Kuvendit të Aksionarëve në lidhje me çështjet e përcaktuara në Nenin 11, paragrafin 1, të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë mund të mos lejojnë apo autorizojnë miratimin e një ndryshimi dhe/apo plotësimi të Statutit dhe/apo të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë që rrit detyrimin e një Aksionari për të bërë kontribute ose eliminon apo zvogëlon të drejtat e një Aksionari, përveç nëse çdo Aksionar i prekur në mënyrë specifike dhe me shkrim ka votuar në favor të një ndryshimi dhe/apo plotësimi të tillë.
- 12. Kuorumi për Mbledhjet e Kuvendit të Aksionarëve**
- 12.1 Mbledhja e Kuvendit të Aksionarëve mund të mbahet vetëm nëse në mbledhje janë të pranishëm Aksionarët që mbajnë shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të Aksioneve të Shoqërisë apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar.
- 12.2 Në rast të mungesës së kuorumit për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve, të thirrur me rregull, mbledhja e radhës e Kuvendit të Aksionarëve do të mbahet brenda periudhës kohore vijuese prej dhjetë (10) ditëve nga data fillestare për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve. Kuorumi për mbajtjen e kësaj mbledhje të Kuvendit të Aksionarëve në këtë rast do të jetë prania e Aksionarëve që mbajnë pesëdhjetë përqind (50%) të Aksioneve të Shoqërisë.
- 13. Kryesimi i Mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve**
- 13.1 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë, ose në mungesë të tij ndonjë zyrtar i Shoqërisë caktuar nga Drejtori Menaxhues i Shoqërisë, vepron si kryesues në mbledhjet e Kuvendit të Aksionarëve.
- 13.2 Megjithatë, nëse Drejtori Menaxhues i Shoqërisë, ose në mungesë të tij ndonjë zyrtar i Shoqërisë i caktuar nga Drejtori Menaxhues i Shoqërisë, nuk është i pranishëm brenda tridhjetë (30) minutave pas kohës së planifikuar për fillimin e mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve, Aksionarët e pranishëm që përbëjnë kuorumin zgjedhin një prej Aksionarëve apo zyrtarëve të Shoqërisë të kryesoj mbledhjen e Kuvendit të Aksionarëve.
- 14. Votat e Aksionarëve**
- 14.1 Në mbledhjen e Kuvendit të Aksionarëve, Aksionarët kanë një votë për çdo çështje të ngritur për vendosje, të cilën votë mund ta ushtrojnë ose personalisht ose nëpërmjet të



përfaqësuesit të autorizuar, i cili duhet të pajisjet me një autorizim të noterizuar, siç është përcaktuar më poshtë.

- 14.2 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me kualifikimin e çdo Aksionari me të drejtë vote përcaktohet në mbledhjen e Kuvendit të Aksionarëve. Çdo mosmarrëveshje e tillë i referohet kryesuesit të mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve, vendimi i të cilit është përfundimtar dhe i zbatueshëm.
- 14.3 Emërimi i përfaqësuesve të autorizuar të Aksionarëve duhet të jetë me shkrim dhe i noterizuar. Një kopje origjinale ose e vërtetuar e autorizimit të noterizuar i dërgohet kryesuesit të mbledhjes së Aksionarëve jo më vonëse dyzet e tetë (48) orë para fillimit të mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve.
- 14.4 Votimi në mbledhje të Kuvendit të Aksionarëve bëhet me ngritje të dorës të Aksionarëve apo përfaqësuesve të tyre, përveç nëse Aksionatët në mënyrë unanime janë pajtuar që votimi të jetë i fshehtë.


## 15. Drejtori Menaxhues i Shoqërisë

- 15.1 Shoqëria do të ketë një Drejtor Menaxhues.
- 15.2 Drejtori Menaxhues është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë.
- 15.3 Drejtori Menaxhues emërohet dhe shkarkohet me votën afirmative të aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi së pakugjashtëdhjetë e pesë përqind(65%) të aksioneve të Shoqërisë.
- 15.4 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë është Berat Buzhala, me numër personal të identifikimit 1013396767, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, dhe me vendbanim në Veternik, rrapa Grand Store, Prishtine.

## 16. Kompetencat e Drejtorit Menaxhues të Shoqërisë

- 16.1 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë do të përfaqësojë dhe detyroj ligjërisht Shoqërinë në raportet e Shoqërisë me palët e treta dhe autoritetet publike dhe do të udhëheqë/qeverisë/menaxhojë të gjitha veprimet afariste/biznesore të Shoqërisë, përveç nëse parashihet ndryshe në Statut dhe/apo me Marrëveshjen e Shoqërisë.
- 16.2 Pa kufizuar kompetencat e Drejtorit Menaxhues të Shoqërisë të parapara me Nenin 16, paragrafin 1, të kësaj Marrëveshje të Shoqërisë, Drejtori Menaxhues ka kompetencë ekskulzive për çështjet në vijim:





- (a) hartimin dhe zbatimin e planit të punës dhe afarit/biznesor të Shoqërisë dhe të kompanive/shoqërive tregtare në pronësi të Shoqërisë;
  - (b) hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Shoqërisë dhe të kompanive/shoqërive tregtare në pronësi të Shoqërisë;
  - (c) punësimin, caktimin e pagave dhe bonuseve si dhe shkarkimin e të gjithë punëtorëve të Shoqërisë dhe të kompanive/shoqërive tregtare në pronësi të Shoqërisë;
  - (d) lidhjen e kontratave dhe/apo marrëveshjeve komerciale për dhe në emër të Shoqërisë;
  - (e) ushtrimin e plotë dhe të pakufizuar të të drejtave të aksionarit për dhe në emër të Shoqërisë në kompanitë/shoqëritë tregtare të cilat Shoqëria i ka në pronësi; dhe
  - (f) të siguroj që Shoqëria zbaton dhe respekton Ligjin në Fuqi.
- 16.3 Drejtori Menaxhues mund të emëroj një apo më shumë Ndhmës Drejtor për çështje të caktuara që do ta këshillojnë dhe/apo ndihmojnë për përmbushjen e detyrave të veta. Ndhmës Drejtorët e emëruar nga Drejtori Menaxhues do të shkarkohen nga Drejtori Menaxhues.
- 16.4 Drejtori Menaxhues dhe Ndhmës Drejtorët e emëruar nga ai janë të detyruar që – gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre – tëiu përmbahen detyrimeve në vijim:
- (a) të veprojnë për dhe në interes të Shoqërisë si tërësi;
  - (b) të ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm për qëllimet e parapara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Statut dhe këtë Marrëveshje të Shoqërisë;
  - (c) të shmangin konfliktet aktuale dhe potenciale të interesave personale me interesat e Shoqërisë; dhe
  - (d) të ushtrojnë kompetencat e tyre me kujdes të arsyeshëm.
17. **Emërimi, Caktimi i Kompensimit dhe Bonuseve si dhe Shkarkimi i Drejtorit Menaxhues**
- 17.1 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë emërohet – me mandat të pacaktuar në kohë – me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë gjashtëdhjetw e pesëpërqind (65%) të Aksioneve në Shoqëri. Emërimi shoqërohet me lidhjen e kontratës së punës për periudhë të pacaktuar kohore ndërmjet Shoqërisë dhe Drejtorit Menaxhues. Kontrata e punës për periudhë të



pacaktuar kohore e Drejtorit Menaxhues të Shoqërisë qeveriset sipas Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, siç është dhe siç mund të ndryshohet kohë pas kohe.

- 17.2 Kompensimi dhe Bonuset e Drejtorit Menaxhues caktohen me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë gjashtëdhjetë e pesëpërqind (65%) të Aksioneve në Shoqëri.
- 17.3 Drejtori Menaxhues i Shoqërisë mund të shkarkohet vetëm për shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe/apo Shkelje të Ligjit në Fuqi, të vërtetuara në një procedurë disiplinore ku Drejtori Menaxhues ka të drejtën e përfaqësimit, me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë gjashtëdhjetë e pesëpërqind (65%) të Aksioneve në Shoqëri.
18. **Qasja në të Dhënat e Shoqërisë**
- 18.1 Çdo Aksionar ka të drejtë të kërkojë nga Drejtori Menaxhuesi Shoqërisëqasjen e çdo libër, dokument dhe të dhëna tjetër të Shoqërisë pa kufizime.
- 18.2 Në veçanti, çdo Aksionar ka të drejtë të marrë kopje të çfarëdo të dhënave dhe/apo dokumenteve të Shoqërisë.
19. **Viti Afarist, Pasqyrat Financiare dhe Shpërndarja e Fitimit/Dividendave të Shoqërisë**
- 19.1 Viti afarist i Shoqërisë është në përputhje me vitin kalendarik.
- 19.2 Drejtori Menaxhues – nëpërmjet të zytarëve të brendshëm apo të jashtëm të kontabilitetit dhe/apo auditimit – përgatitë pasqyrat financiare të të Shoqërisë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga fundi i vitit afarist/kalendarik.
- 19.3 Përcaktimi i fitimit dhe humbjes për qëllime të pasqyrave financiare bëhet në përputhje me Ligjin në Fuqi.
- 19.4 Pasqyrat financiare të Shoqërisë miratohen në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Aksionarëve të Shoqërisë.
- 19.5 Secili fitim i realizuar në vitin paraprak shpërndahet/paguhet si fitim/dividend tek Aksionarët, në proporcion me Aksionet që mbajnë/kanë në pronësi, përveç nëse mbledhja e Kuvendit të Aksionarëve vendos ndryshe.
- 19.6 Fitimi/dividenda shpërndahet/paguhet tek Aksionarët e Shoqërisë vetëm nëse nuk ekzistojnë asnjë nga kufizimet e parashikuara në Nenin 93 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.



19.7 Vetëm Aksionarët të cilët janë në regjistrin e Aksionarëve dhe janë të përcaktuar dhe regjistruar si të tillë në Statut në ditën e mbledhjes së Kuvendit të Aksionarëve, ku shpallen fitimet/dividendat, kanë të drejtë të marrin këto fitime/dividenda.

**20. Njoftimet**

20.1 Çdo njoftim që lëshohet/ipet për Aksionarët lidhje me këtë Marrëveshje të Shoqërisë bëhet me shkrim dhe në adresat e Aksionarëve të dhëna këtu dhe/apo email më email adresat e dorëzuara nga Aksionarët në Shoqëri.

20.2 Komunikimi me email konsiderohet të jetë komunikim me shkrim për qëllime të këtij Neni 20 të Marrëveshjes së Shoqërisë.

20.3 Aksionari qështë i pranishëm në një mbledhje të Shoqërisë, qoftë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar, konsiderohet se ka marrë njoftimin për mbledhjen për të cilat mbledhja është organizuar.

**21. Ligji Qeverisës dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

21.1 Kjo Marrëveshje e Shoqërisë qeveriset nga dhe interpretohet në pajtim me Ligjin në Fuqi.

21.2 Aksionarët do të përpiqen të zgjidhin secilën dhe të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet vete në mënyrë miqësore.

21.3 Në rast se zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mënyrë miqësore nuk mund të bëhet brenda afatit kohor prej njëzet (20) ditëve, secili Aksionar ka të drejtë që zgjidhjen e mosmarrëveshjes ta kërkoj pranë gjykatës kompetente.

**22. Shpërbërja Vullnetare dhe Falimentimi i Shoqërisë**

22.1 Shpërbërja vullnetare e Shoqërisë miratohet me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të Aksioneve të Shoqërisë.

22.2 Shpërbërja vullnetare e Shoqërisë do të bëhet në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

22.3 Nisja e procedurës për falimentim të Shoqërisë miratohet me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të Aksioneve të Shoqërisë.

22.4 Procedura e falimentimit të Shoqërisë do të zhvillohet në pajtim me Ligjin në Fuqi.

**23. Ndarja dhe Bashkimi i Shoqërisë**



- 23.1 Ndarja e Shoqërisë miratohet me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të Aksioneve të Shoqërisë.
- 23.2 Bashkimi i Shoqërisë me ndonjë subjekt tjetër juridik miratohet me vendimin afirmativ të Aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të Aksioneve të Shoqërisë.
- 23.3 Ndarja dhe bashkimi i Shoqërisë do të bëhet në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
24. Dispozitat Përfundimtare
- 24.1 Kjo Marrëveshje e Shoqërisë hyn në fuqi më 01.03.2018.
- 24.2 Kjo Marrëveshje e Shoqërisë mund të ndryshohet dhe/apo plotësohet me votën afirmative të aksionarëve që mbajnë/kanë në pronësi së paku shtatëdhjetë e pesë (75%) të aksioneve të Shoqërisë.
- 24.3 Në rast të miratimit të ndryshimit të kësaj Marrëveshjeje e Shoqërisë, aksionarët do të përgatisin dhe miratojnë tekstin e ndryshuar dhe të rishkruar (konsoliduar) të Marrëveshjes së Shoqërisë.

Aksionarët e N.B. "Media Works" Sh.p.k.

Berat Buzhala

Vjollca Musa

Artan Lahaj

Leonard Kërquku

Shpend Limoni

Arben Hyseni

[vula]





REPUBLIKA E KOSOVËS  
NOTERE MERITA KOSTANICA

Numri Rendor i LRP 962/2018

-----VËRTETIM NËNSHKRIMI-----

Sot, me 01.03.2018 (një mars dy mijë e tetëmbëdhjetë), para meje, Merita Kostanica, Notere me seli në Rr."Zahir Pajaziti", Hyrja, Nr. 20, Kati 1, Numër 1, Prishtinë, u paraqitën:-----

- 1) BERAT BUZHALA, i lindur në Çabiq me datë 22.11.1975, emri i babës Bashor, sipas deklaratës së tij me adresë në Veternik, Mbrapa Grand Store, Prishtinë 10000, Kosovë, identiteti i të cilit është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 1013396767, i lëshuar nga MPB me datë skadimi 28.08.2027;-----
- 2) VJOLLCA MUSA, e lindur në Mitrovicë me datë 07.03.1963, emri i babës Hashim, sipas deklaratës së saj me adresë në Bregu i Diellit, Zona Perendim Hyrja 4/13, Prishtinë 10000, Kosovë, identiteti i të cilit është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 2003940317, i lëshuar nga MPB, me datë skadimi 22.11.2026;-----
- 3) ARTAN LAHAJ, i lindur në Gjakovë me 10.05.1978, emri i babës Haxhi, sipas deklaratës së tij me adresë në Rr. Kalabria, blloku: B2, Llamella B nr.26, Prishtinë 10000, Kosovë, identiteti i të cilit është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal me numër personal 1001144703 i lëshuar nga MPB, me datë 12.10.2027; -
- 4) LEONARD KËRQUKU, i lindur në Gjakovë me datë 05.11.1981, emri i babës Mark, sipas deklaratës së tij me adresë në Lagja 038 pa numër Veternik, Prishtinë 10000, Kosovë, identiteti i të cilit është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 1001478342, i lëshuar nga MPB me datë skadimi 13.10.2025;-----
- 5) SHPEND LIMONI, i lindur në Gjilan, me datë 18.11.1979, emri i babës Ibrahim, sipas deklaratës së tij me adresë në Hodonoc, pa numër, Kamenicë, Kosovë, identiteti i të cilit është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 1003064421, i lëshuar nga MPB me datë skadimi 01.02.2027;-----
- 6) ARBEN HYSENI, i lindur në Pejë, më datë 09.05.1984, emri i babës Simon, sipas deklaratës së tij me adresë në Rr. "Sali Çeku", Dardania 1, Pejë, identiteti i të cilit është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 1009408106, i lëshuar nga MPB me datë skadimi 20.07.2025;-----






BERAT BUZHALA, VJOLLCA MUSA, LEONARD KËRQUKU, ARTAN LAHAJ, SHPEND LIMONI dhe ARBEN HYSENI, paraqitën në cilësinë e aksionarëve të vetëm N.B. "Media Works" Sh.p.k., e regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me seli në Prishtinë, Rexhep Luci, 16/3, me numër të regjistrimit të biznesit 70202640, fakt i cili konstatohet nga "KONTRATË PËR TRANSFERIN E AKSIONEVE TË N.B. "Media Works" Sh.p.k. me numër rendor LRP 952/2018 dhe numër reference 203/2018", e datës 01.03.2018. -----

BERAT BUZHALA, VJOLLCA MUSA, ARTAN LAHAJ, LEONARD KËRQUKU, SHPEND LIMONI dhe ARBEN HYSENI në cilësinë e lartëshënuar kërkojnë nga ana e Noteres:-----

- Vërtetimin e nënshkrimit të tyre në dokumentin e sjellur, të përgatitur nga vet ata, përkatësisht në dokumentin "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË N.B. "Media Works" Sh.p.k", datë 01.03.2018, i cili ka gjithsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) faqe dhe 8 (tetë) fletë dhe i është bashkangjitur këtij vërtetimi. Ky dokument është sjellur nga pala në 3 (tri) kopje. -----

Këtu e tutje, në përputhje me Nenin 45 të Ligjit të Noterisë, Noterja vërteton se: -----

1. BERAT BUZHALA me të dhënat e lartëshënuara dhe në cilësinë e lartëshënuar në emër të N.B. "Media Works" Sh.p.k., në prani të Noteres, ka vënë nënshkrimin e tij në çdo faqe të dokumentit "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË N.B. "Media Works" Sh.p.k", datë 01.03.2018 në gjithësej 3 (tri) kopje. -----
2. VJOLLCA MUSA me të dhënat e lartëshënuara dhe në cilësinë e lartëshënuar në emër të N.B. "Media Works" Sh.p.k., në prani të Noteres, ka vënë nënshkrimin e saj në çdo faqe të dokumentit "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË N.B. "Media Works" Sh.p.k", datë 01.03.2018 në gjithësej 3 (tri) kopje. -----
3. ARTAN LAHAJ me të dhënat e lartëshënuara dhe në cilësinë e lartëshënuar në emër të N.B. "Media Works" Sh.p.k., në prani të Noteres, ka vënë nënshkrimin e tij në çdo faqe të dokumentit "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË N.B. "Media Works" Sh.p.k", datë 01.03.2018 në gjithësej 3 (tri) kopje. -----
4. LEONARD KËRQUKU me të dhënat e lartëshënuara dhe në cilësinë e lartëshënuar në emër të N.B. "Media Works" Sh.p.k., në prani të Noteres, ka vënë nënshkrimin e tij në çdo faqe të dokumentit "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË N.B. "Media Works" Sh.p.k", datë 01.03.2018 në gjithësej 3 (tri) kopje. -----
5. SHPEND LIMONI me të dhënat e lartëshënuara dhe në cilësinë e lartëshënuar në emër të N.B. "Media Works" Sh.p.k., në prani të Noteres, ka vënë nënshkrimin e tij në çdo faqe të dokumentit "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË N.B. "Media Works" Sh.p.k", datë 01.03.2018 në gjithësej 3 (tri) kopje. -----
6. ARBEN HYSENI me të dhënat e lartëshënuara dhe në cilësinë e lartëshënuar në emër të N.B. "Media Works" Sh.p.k., në prani të Noteres, ka vënë nënshkrimin e tij në çdo faqe të dokumentit "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË N.B. "Media Works" Sh.p.k", datë 01.03.2018 në gjithësej 3 (tri) kopje. -----



Gjithësej janë vënë 288 (dyqind e tetëdhjetë e tetë) nënshkrime para Noterit në gjithësej 3 (tri) kopje të dokumentit të lartëshënuar.

Noterja nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e Dokumentit "MARRËVESHJE TË SHOQËRISË N.B. "Media Works" Sh.p.k", datë 01.03.2018 në gjithësej 3 (tri) kopje.

Ky vërtetim ka gjithësej 3 (tri) faqe dhe 2 (dy) fletë.

Ky vërtetim është kërkuar nga pala dhe përgaditur nga ana e Noteres në 3 (tri) kopje.

Shpenzimet noteriale për vërtetimin e nënshkrimit janë llogaritur dhe paguar në vlerë prej € 288 (dyqind e tetëdhjetë e tetë euro) + TVSH, në bazë të nenit 29, të Udhëzimit Administrativ 02/2012 për Tarifat e Përkohshme Noteriale, bazë për pagesën e shërbimit të noterëve.

Identiteti i palës është konstatuar sipas dokumentit të identifikimit me të dhënat e lartëshënuara. Është konstatuar se pala ka aftësi të plotë veprimi.

Veprimi i noterizimit u krye në Prishtinë, në selinë e Noteres Merita Kostanica në adresën e lartëshënuar me datën 01.03.2018 (një mars dy mijë e tetëmbëdhjetë).



NO  
TIA



Vërtetim kopje nga dokumenti original. -----

Në përputhje me Nenin 43 të Ligjit për Noterinë, vërtetohet se ky dokument është kopje e dokumentit original "MARRËVESHJE TË SHQËRISË të N.B. "Media Works" Sh.p.k.", i datës 01.03.2018, nënshkrimet e të cilit janë vërtetuar te Noteri, në bazë të „VËRTETIM NËNSHKRIMI“ me numër rendor LRP. 962/2018, më datë 01.03.2018, e cila është identike me origjinalin e saj, e përcaktuar nga vetë pala si dokument original. -----

Dokumenti përbëhet prej 19(nëntëmbëdhjetë)faqe dhe 10(dhjetë)fletë dhe e njeja vërtetohet në 2(dy)kopje, në vlerë prej € 38 (tridhjetë e tetë euro). -----

Ky vërtetim është kërkuar "GAZETA EXPRESS" SH.P.K. me numër të regjistrimit të biznesit 810104183, përfaqësuar nga VJOLLCA MUSA, e lindur në Mitrovicë me datë 07.03.1963, emri i babës Hashim, sipas deklaratës së saj me adresë në Bregu i Diellit, Zona Perendim Hyrja 4/13, Prishtine, identiteti i të cilës është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 2003940317, i lëshuar nga MPB, me datë skadimi 22.11.2026. -----

Noterja vërteton se kjo kopje është bërë në zyrën noteriale dhe në të gjitha pikëpamjet është konform (kopje autentike) me dokumentin original që i'u prezantua noteres nga vetë pala. -----

Noterja nuk mbanë përgjegjësi për përmbajtjen e Dokumentit. -----

Prishtinë, Notere Merita Kostanica, me datë 11.09.2018. -----

APOSTILLE	
(Convention de La Haye du 5 Octobre 1961)	
1. Shtet/Drzava/Conutry: REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO	
Ky dokument publik / Ovaj javni dokument / This public document	
2. është firmosur nga/je potpisan od strane/has been signed by	M. KOSTANICA
3. i cili vepron në cilësinë e/koji deluje u svojstvu/acting in the capacity of	NOTERE
4. dhe mban vulën/pullën/i zadržava markicu/has the seal/stamp of	O.N.K
Vërtetohet / Potvrđuje se / Certified	
5. në/uzat	PRISHTINE
6. datë/datum/date	12.09.2018
7. nga/od/by	DGKIMPJ
8. nr/br/no.	55454/KP
9. vula/pulla /peçat/markica/seal/stamp	
10. nënshkrimi/potpis/peçare:	

